

**ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS  
(AKK)**

**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT E  
BURIMEVE DHE PËRDORIMIT TË FONDEVE  
PËR FUND VITIN 31 DHJETOR 2009**

**PËRMBAJTJA**

	<b>FAQE</b>
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	
PASQYRA E BURIMEVE DHE PËRDORIMIT TË FONDEVE	3
SHËNIMET E PASQYRAVE TË BURIMEVE DHE PËRDORIMIT TË FONDEVE	3 – 10
SHTOJCA 1	11

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### Për Menaxhmentin e Asociacionit të Komunave të Kosovës

Ne kemi audituar pasqyrat e burimeve dhe përdorimit të fondeve dhe një përmbledhje të procedurave të rëndësishme kontabël dhe notave tjera shpjeguese "Pasqyra" e Asociacionit të Komunave të Kosovës ("AKK"), për fund vitin 31 Dhjetor 2009. Pasqyra më dhe për fund vitin 31 Dhjetor 2008 nuk është audituar dhe ne nuk shprehim opinion për ato.

#### *Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrën*

Menaxhmenti i AKK-së është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrës në përputhje me pranimin e parasë dhe pagesave sipas bazës kontabël e dhënë në shënimin 2 të Pasqyrës. Kjo përgjegjësi përfshin: dizajnimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrës e cila nuk përmban deklarata materialisht të gabuara, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; duke zgjedhur dhe zbatuar politika të përshtatshme kontabël; dhe duke bërë vlerësime kontabël që janë të arsyeshme në rrethanat përkatëse.

#### *Përgjegjësia e Auditorit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim opinion për Pasqyrën bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike si dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme që Pasqyra nuk përmban deklarata materialisht të gabuara.

Auditimi përfshinë përmbushjen e procedurave për të marrë dëshmi të auditimit për shumat dhe shpalosjet në Pasqyrë. Procedurat e përzgjedhura varen nga vlerësimet e auditorit, përfshirë vlerësimet e rrezikut të deklaratave materialisht të gabuara qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në arritjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori merr parasysh kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrës të entitetit në mënyrë që të përcaktoj procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit në efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të Pasqyrës.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne i kemi përdorur janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.